



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

DREJTORIA JURIDIKE , BURIMET NJERËZORE DHE PROKURIMET PUBLIKE

Nr. 5538 Prot

Maliq, më 25.10.2022

Lënda: Kërkesë për shpallje

Drejtuar: Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Mardhënieve me Publikun

Këtu


Njesisë Administrative Vreshtas

Në mbështetje të Kreut II, pika 3 të Udhëzimit Nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, bashkangjitur ju dërgojmë shkresën “Njoftim Publik” me Nr. 5537 Prot, datë 25.10.2022, për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandarë me Nr. Pasurie 90/40, Zonë Kadastrale 3010, Sipërfaqe 704 500 m², Fshati Podgorie, Njësia Administrative Vreshtas, në mënyrë që të bëni të mundur shpalljen e saj në ambjentet publike, gjithashtu dhe në faqen zyrtare të webit të Bashkisë Maliq nga ana e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit.

Ju faleminderit !

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU



Nr. 113 Prot



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. 537 Prot

Maliq më, 25.10.2022

NJOFTIM PUBLIK

Në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, gërma a, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 8312 datë 26.03.1998 “Për Tokat Bujqësore të Pandara”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.364, datë 01.04.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Vreshtas të Qarkut të Korçës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 21.08.1998 “Për Tokat Bujqësore të Pandara”, Udhëzimit Nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, Kreu I pika 5, Kreu II pika 1 dhe 3, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.71, datë 30.09.2016 “Për miratimin e listave të tokave bujqësore të pandara me qëllim dhënien me qira të tyre, për Njësitë Administrative Pirg, Vreshtas dhe Pojan”, i ndryshuar;

Bashkia Maliq, njofton se jep me qira tokën bujqësore të pandarë me ligjin Nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, me Numër Pasurie 90/40, Zonë Kadastrale 3010, Sipërfaqe 704 500 m², Fshati Podgorie, Njësia Administrative Vreshtas.

Të interesuarit të paraqesin kërkesat e tyre pranë Bashkisë Maliq, brenda datës **01.11.2022**.

Ankandi për dhënien e tokës me qira do të zhvillohet në datën **17.11.2022**, ora **10:00**, pranë Bashkisë Maliq.

KRYETAR I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

